

UDC 316.423.2/.3:321.7 (5-011)

Shkodran H. ISMAILI¹

VALA E KATËRT E DEMOKRATIZIMIT DHE LINDJA E MESME:

“implikimet e vona të pas Luftës së Ftohtë”

ЧЕТВРТИОТ БРАН НА ДЕМОКРАТИЗАЦИЈА И СРЕДНИОТ ИСТОК:

“подоцнежните импликации после Студената Војна”

THE FOURTH WAVE OF DEMOCRATIZATION AND THE MIDDLE EAST:

“the late implications of after Cold War”

Abstract:

The fourth wave of democratization in the middle east as some are trying to name it (Huntington as a determinates of three first waves and survey: Regional transition to democracy, 2011) or a wave of re-determination of postcolonial and post soviet “democracy” , or post cold war if we can say?!

So this is re-determination of these secular values in so called “Arab spring” which already is including world political geography and Muslim societies in general is an attempt a for as long survive of secular principles and these kind of superstructure in this region. Initialized for westernization and euro-American centric, these values which already sown in foreign land are in constant decline and melting from self-perception of people of this region, which already one century (in previous century XX as institutional and official installation) didn't bring long term silence and peace, but only conflict as between each other and also with Israel.

Attempts to keep in control this very important region of Rimland, or we have really authentic democratic revolutions, which masses leads to bring in power democratic representation of their will?!

The so called “Arab spring” in the beginning was seen as an opportunity for improvement and change of all ex institutional superstructures and stratifications of classical and post classical colonialism and the changes that post-soviets bring!? As the time passes, especially with fake (falco) antidemocratic coup to

¹ Autori është i diplomuar në Master të së Drejtës Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës dhe mban titullin LL.MA – Master i shkencave juridike-ndërkombëtare. Hulumtues i ri dhe i pavarur shkencor.
E-mail: ismailshkodran@gmail.com

president Morsi in Egypt, prove our thesis that we neither have to deal with fourth wave of democratization (Huntington and others) nor with serious democratic changes, but with an interruption of an “late awake of after cold war” and their nested east-west interest as continuation of geopolitical global disagreement of different fields of impact and control!

Key words: *The Fourth Wave of democratization; The Middle East; The Democratic revolution; The Arab spring; the post Cold War.*

Abstrakt:

Valë e katërt e demokratizimit (the fourth wave of the democratization) në Lindje të Mesme siç po mundohen ta emërtojnë (Huntington si përkufizues i tri valëve të para dhe studimi: Regional Transition to democracy, 2011) apo një valë e ri-përkufizimit të “demokracisë” post-koloniale si epokë e vonë e post Luftës së Ftohtë?!

Këtu kemi të bëjmë me ri-përkufizim të vlerave shekullore në të quajturën “pranverë arabe” që tanimë po përfshinë gjeografinë politike të botës dhe të shoqërive muslimane në përgjithësi, e cila është një përpjekje për mbijetesë sa më afatgjate të parimeve shekullore, frymës apo superstrukturës së tillë në këtë rajon. Të instaluara për qëllime vesternizuese dhe euro-amerikano centriste, ato tanimë si vlera të mbjella në dheun e huaj janë në rënie e sipër dhe në shkrirje, nga vetëperceptimi i popullit të këtij rajoni, të cilat tanimë që një shekull (në shekullin e kaluar XX si instalime institucionale-zyrtare) nuk i sollën qetësi dhe paqe afatgjatë popullit arab, por vetëm konflikte, as mes veti po as mes Izraelit, si ngulim i ri shtetëror!

Përpjekje për mbajtjen ende në kontroll të këtij regjioni shumë të rëndësishëm të Rimlandit, apo kemi me të vërtetë revolucione të mirëfillta demokratike varg, të cilat masat e gjera të popullit i udhëheqin për të sjellë në pushtet përfaqësimin demokratik të vullnetit të tyre?!

E quajtura “pranvera arabe”, në fillim u pa si një mundësi përmirësimi dhe ndryshimi të të gjithë atyre superstrukturave institucionale-shtetërore dhe shtresëzimeve të kolonializmit klasik, atij post klasik dhe ndryshimeve të cilat i pruri postsovetizmi!? Mirëpo me kalimin e kohës, sidomos me grushtshtetin falco antidemokratik dhe rrënimin me dhunë të Presidentit Mursi në Egjipt, tanimë e vërtetojnë tezën se këtu nuk kemi të bëjmë fare as me Valën e Katërt të demokratizimit (Huntington dhe të tjerë) as me ndryshime demokratike të njëmendta, por me një ndërhyrje të një “zgjatimi të vonë të pas Luftës së Ftohtë” dhe gërshetimit të interesave të saj më të pista Lindje – Perëndim si vazhge e mosmarrëveshjeve globale gjeopolitike të ndarjes së sferave të ndikimit dhe kontrollit!

Fjalë kyçe: *Vala e katërt e demokratizimit; Lindja e Mesme; Revolucioni demokratik; Pranvera arabe; dhe post Lufta e Ftohtë.*

Përplasjet gjeopolitike për Lindjen e Mesme

Si duket, në Lindjen e Mesme nuk kanë të ndalur trazirat dhe përpjekjet për “normalizim” të rajonit, pas shumë atyre ndodhive të cilat lanë shumë viktime, pas ndërhyrjes dhe pushtimit Amerikan të Afganistanit dhe Irakut, fillimit të së quajturës “pranverë arabe” me Tunizinë më 2011 dhe çështjeve tjera të cilat janë një element edhe më shumë destruktiv për jonormalizimin dhe jostabilitetin e rajonit në epokën e pas’sovjetizmit dhe pas Luftës së Ftohtë.

Menaxhimi post’sovjetik i këtij rajoni edhe nga Shtete e Bashkuara edhe nga Federata Ruse por dhe nga të gjitha Fuqitë e Mëdha të cilat i njeh bota dhe kolonitë e të cilave i njohim të gjithë, për keqardhje është një përpjekje shtysë për post’rikolonizim dhe kontrollim deri në fund. Në shumë drejtime kjo ngjanë si zgjatim i proceseve të lëna pezull në para Luftën e Dytë Botërore, kur bota evro-amerikane u pajtuan në heshtje më një fjalë, që ta lënë kolonializimin (sidomos të këtij rajoni. SH.I.), në favor të marrjes së pavarësisë së kolonive të veta, për ta luftuar si prioritet komunizmin-socializmin si një “e keqe edhe më e madhe” dhe rrezik më i ngutshëm. Ashtu siç shpjegon studiuesi amerikanë Inis Claud (1967) dekolonializimi “triumfoi” gjerësisht, sepse *“perëndimi i dha përparësi frenimit të komunizmit më shumë sesa përjetësimin të kolonializmit.”*²

Lindja e Mesme në pas’sovjetizëm është njëra ndër krizat dhe çështjet më të rëndësishme të Rimlandit dhe të pjesës euro-aziatike të globit si një arenë e rregullt kolizioni dhe konfrontimi ndërmjet fuqive të mëdha dhe shteteve tjera të interesuara për impaktin e tyre. Në shekullin e Njëzetë e një, gjegjësisht në pjesën e parë të tij dhe në epokën post’sovjetike, përsëri Rimlandi (pjesa e Lindjes së Mesme të Rimlandit. SH.I.) është “potezi” më i volitshëm për përplasjen e këtyre interesave, si subjekt aktiv i historisë³, e cila ka krijuar dhe konstituuar konceptin esencial të saj, pra historisë me të gjitha nënkuptimet e saj!?

Prandaj, ky rajon është dhe ende do të jetë arenë përplasjesh dhe konfliktesh ndërmjet fuqive të mëdha edhe në fillimshekullin e Njëzet e një, derisa rikonfigurimi i historisë të mos rikthehet me ngulime te ata popuj që janë rrënjës, pra derisa ata të fillojnë seriozisht të bëhen prodhues të

² “POLITIKAT BOTËRORE - tendenca dhe transformim”; Charles Kegley JR, f. 13. SHB UFO Press, Tiranë, Mars 2008.

³ “GJEOPOLITIKA”; Shamsi Ajvazi, Dija, Prishtinë, 2009, f. 25.

historisë dhe jo konsumues pasiv të tyre!?! Tani, kjo që po ndodhë është vetëm fillimi i përpjekjes së gjatë në rrugëtimin e historisë për rikthimin e krenarisë së humbur, dhe përjetimet e dhembjeve të një lindje të re, por për fat të keq si duket lindje cezariane, prerjet e së cilës do të lënë pasojë në hartën dhe subjektivizmin e saj.

Gjeopolitika e pas Luftës së Ftohtë në Lindje të Mesme

Ky rajon ende është njëri ndër më të nxehtit në përplasjet e vazhdueshme edhe në *zgjatimet-implikimet e vona të pas Luftës së Ftohtë* e cila zgjati nga 1945 deri më 1995 (Partos;1993) dhe pambarimit të ndarjes së sferave të interesit, sidomos në pjesën e Rimlandit të Lindjes së Mesme, si strumbullari dhe udhëkryqi i gjeopolitikës së globit. Siç është e njohur, rajoni ka qenë fushë e përplasjes së interesave të superfuqive dhe ndarjes së tyre që nga antikiteti dhe kjo është lexuar shumë mirë nga strategët e kohërave, duke u bartur kjo trashëgimi deri më tani.

Implikimeve të vona apo dhe të pambaruara të para (pas) Luftës së Ftohtë, mund dhe t'i gjejmë përgjigje në përkufizimet e përmendura më herët të studiuesit dhe profesorit amerikan të Harvardit Inis Claud, i cili thekson pambarimin e kolonizimit të kësaj pjese të rajonit (apo dhe të tjerave pjesë të globit) për t'i dhënë përparësi luftës dhe supremacisë së perëndimit euro-amerikan kundër komunizmit pas LDB-së si një e "keqe" me e ngutshme i cili e kërcënonte gjithë Evropën, e ndoshta dhe Amerikën.

Pra, implikimet e vona apo të pas Luftës së Ftohtë dhe interesat për vazhdimin e kolonizimit apo post'kolonizimit në këtë epokë pas rënies dhe fitores së perëndimit kundër lindjes (pra BRSS dhe tjerëve) me një ri'konceptualizim të këtij procesi të mbetur pezull si ndarje e sferave të interesit dhe vazhdimësi e impaktit të fuqive me kompromisin mes tyre, edhe sot po e harton dhe konfiguron hartën gjeopolitike të rajonit, vetëm me disa metoda të reja të shpikjes së "mjeteve-veglave më të përsosura" për ta arsyetuar qëllimin. Gjeopolitika e pas Luftës së Ftohtë në këtë rajon është në shumë drejtime mbetje, vazhdim dhe rikonfigurim i gjeopolitikës së para Luftës së Dytë Botërore, pra s më shumë e as më pas se vazhdim i strategjisë/ive të gjeopolitikave të Superfuqive që kalkulojnë me gjysmë shekuj e shekuj si menaxhime globale, asgjë më shumë.

Valët e demokratizimit dhe vala e katërt?!

pro dhe kundër

A është pranverë e cila paralajmëron demokracinë e vërtetë të rajonit dhe popujve të saj, tanimë e quajtur edhe si *valë e katërt e demokratizimit*, apo kemi të bëjmë me kamuflime të një kuazidemokracie e cila vetëm përfytyrohet nga këta popuj, por që në të vërtetë është një vazhdim i një “plani global” për regjimet autoritare, rasti me Egjiptin dhe Presidentin e saj dhe regjime të “dëgjueshme” siç është rasti me Arabinë Saudite dhe shtetet tjera të Gjirit e rajonit!?

Sipas Huntingtonit, dy valët e para të demokratizimit kanë të bëjnë: njëra në fund të shekullit XIX dhe fillimin e XX-tës dhe që shtrihet deri në Luftën e Parë Botërore, ndërsa vala e dytë është me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore. Pra, që të dyja në kuadrin institucional përfshijnë rënien e regjimeve autoritare (feudalizmit, nazizmi, fashizmi etj.) dhe mbizotërimin e demokracive popullore, dhe pse jo edhe të atyre liberale apo neoliberales (nga pas LDB e kënde; nënv. SH.I.) si një antitezë e tyre. Vala e tretë ka të bëjë me triumfin e botës perëndimore kundër komunizmit e socializmit, gjë që edhe e përfshin një kuadër historik nga fillimvitet e shtatëdhjeta e deri në vitet 1990-1992, ndryshimet kushtetuese-ligjore dhe politike të cilat i bënë dhe orientimet euro-atlantike të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Çështja me valën e katërt dhe mbizotërimin e demokracive perëndimore, e sidomos të asaj liberale kundër komunizmit dhe socializmit si forma më të përsosura të vetëqeverisjes së institucioneve komunitare në botë, e rëndon disi këtë kuadër materie edhe më shumë. Madje këtu në këtë pikë të kësaj materia, Huntington “ka rënë në kurth” kur është ngutur ta shpallë triumfin përfundimtar dhe impaktin global të perëndimit (demokracisë liberale) me kuadrin epistemologjik-institucional në format e qeverisjes dhe rregullimit-organizimit politik si vlerë universale ndaj të gjithë anëve tjera të globit, sikur globi të mos kishte edhe tri anë tjera.

Pra, kur jemi këtu në këtë pikë, edhe më shumë çështja e trajtimit dhe qasjes së të quajturës *valë e katërt* e ka në përmbajtjen e vetë atë formulën “diferentia specifika” nga unifikimi me këtë valë universale të demokratizimit të kombeve dhe popujve të globit dhe më këtë edhe të Lindjes së Mesme si rajon dhe botë muslimane!?

Prandaj, unifikimi dhe njësimi me të tri valët tjera, por sidomos me atë të tretën si valë (gjë që kjo pikë është materie diskutimi) demokratizimi me triumfin përfundimtar të demokracisë liberale kundër komunizmit socialist dhe shpallja “e fundit të historisë” nga Fukajama dhe evoluimit të mendimit njerëzor për format e qeverisjes dhe organizimit politik, është e njëanshme, e ngutshme dhe disi nuk i merr parasysh edhe epistemologjitë e Jugut, pra jugut të globit (Manuel Barreto; Epistemologies of the South and Human Rights) apo dhe gnoseologjinë, epistemologjinë e botës muslimane dhe trashëgimin intelektual të saj për format e qeverisjes dhe organizimit politik. Kjo formula e “fundit të historisë” tanimë nga shumë studiues ka marrë konsensusin e duhur si “kundërtezë” se është e ngutshme dhe në shumë elemente është jo e saktë (Davutoglu; Barreto; Esposito; Ahmed; Sardar etj.) gjë që është jo e qëndrueshme në rrethet akademike dhe filozofike të studiuesve të cilët “përfaqësojnë” në një mënyrë anën tjetër të medaljes.

Antropo-filozofia socio-politike dhe demokracia e valës së katërt

Kam bindje të thellë racionale se dimensionin filozofik apo do ta quaja antropo-sociopolitik i *valës së katërt të demokratizimit* të cilën tanimë e cilësojnë shumë studiues të huaj, që sipas tyre ka filluar me Tunizinë në janar të vitit 2011 dhe e quajtur si rimëkëmbja ose zgjimi arab (Regional Transition to democracy, 2011) është në esencë e ndryshme dhe e diferencuar nga ato tri valët tjera të demokratizimit. *Popujt muslimanë të Lindje së Mesme në esencë janë duke kërkuar një erë të re demokratizimi - atë të deshektuarizimit të jetës institucionale të tyre dhe të dekolonializimit të gjithë strukturës së tyre jetësore!?*

Këtë janë duke e kërkuar që shumë kohë, e sidomos që dy dekada e gjysmë që pas rënies së komunizmit e këndej, duke bërë përpjekje të pandalshme për ardhjen në pushtet të demokracisë popullore të votës së lirë, tamam ata të cilat populli i zgjedh. Sido që ta interpretojmë këtë çështje, hermeneutika dhe semantika socio-politike dhe kulturore-civilizuese e këtyre trazirave, e kësaj krize të thellë që ka të bëjë në radhë të parë me kthesë të rëndësishme në vetëperceptimin qytetërimor (Davutoglu, 2001) me rrënjë në kërkimin e vetes dhe subjektivizmit të humbur në “rrotën e historisë” mund të lexohet si jo e përshtatshme (e diferencuar) në shumë elemente konstituive të fenomenit të shfaqur me atë të quajtur si *valë e katërt e demokratizimit* dhe përpjekje për njësim me ato.

Sidomos është e papranueshme përpjekja me ngjasimin, apo njësimin me valën e tretë të demokratizimit të cilën Huntington dhe të tjerë studiues e interpretojnë si revolucion e popujve të Amerikës Latine në mesin e viteve të 74 dhe 80 -ta dhe të atyre të Evropës Lindore Qendrore dhe Juglindore në vitet 1988-89 e tutje, të kthyer kundër diktaturave komuniste të instaluar në shtetet e tyre, satelitëve të sovjetizimit dhe gjithë atij kuadri strukturor të socializmit komunist e marksizëm leninizmit.

Ky revolucion, apo ky ndryshim e kthesë kushtetuese - ligjore dhe politike e rënies dhe rrënimit të komunizmit sovjetik dhe socializmit të tij në këto shtete dhe rajone të lartpërmendura, “unifikohet” në shumë elemente esenciale (përfshijto disa popuj të Amerikës Latine dhe disa të Evropës Lindore edhe Ballkanit Perëndimor të cilëve kjo prerje rapide dhe kategorike nuk u përshtatet në palcën e tyre dhe rrënjët kulturore e antropologjike - civilizuese) me valët e

demokracisë liberale apo qeverisjes liberale demokratike perëndimore. Kjo është kështu, apo dhe mund të jetë kështu sepse pjesa dërmuese e këtyre kombeve janë të së njëjtës vijë antro-po-sociale dhe kulturore-civilizuese me stilin dhe modelin perëndimor i cili e ka prodhuar këtë model qeverisje. Dallimet në vetëpërkufizimin dhe vetëperceptimin e hapësirës në të cilën jetojnë dhe botëkuptimit filozofik - spiritual të cilin e kanë këta popujt e përmendur të këtyre rajoneve janë “unike” me përjashtimet të cilat i përmendëm, në esencën e entitetit të tyre!

Kjo që po e themi, e arsyeton edhe faktin se këto njësi dhe unifikimi me këto valë demokratizimi të cilat fillimisht i kategorizon dhe interpreton Huntington (Vala e Tretë: demokratizimi në fund të shekulli të njëzetë; Tiranë: AIIS, 2011) kanë të bëjnë me përkufizimet rajonale të globit të cilat vetë politikbërja euro-amerikane i ka cilësuar dhe kategorizuar me emërtime si “bota e tretë” apo “ vende në zhvillim” etj. të cilat janë tregues të qartë të një kategorizimi epistemologjik euro-centrist dhe euro-përjashtues ndaj të tjerëve, prandaj nuk mund të qëndron edhe në këtë dimension!?

Këto emërtime që burojnë nga vetë mendimi euro-amerikan janë treguesit më të mirë të “differentia specifika” të asaj filozofisë antropologjike dhe socio-politike të gjeopolitikës euro-centriste përjashtuese ndaj të tjerëve!? Urojmë që në të ardhmen këto diferencime të shlyhen, sidomos me globalizimin e lëvizjes së lirë të njerëzve, mallrave dhe ideve, gjë që kjo e fundit është më se e rëndësishme!?

Qasja epistemologjike e “valës së katërt”

Qasja epistemologjike e të quajturës “valë e katërt” demokratizimi që kinse ka filluar me të a.sh.q. “pranverë arabë” e prekë në shumë drejtime trashëgimin intelektuale të botës muslimane-islame, pra të të gjithë atij kuadri institucional - epistemologjik tradicional të cilin e ka bartur “trupi i mendjes islame - muslimane” deri më sot!?

Logjika e vazhdueshme e këtyre trazirave soci-politike, e këtyre krizave të vazhdueshme në këtë rajon, ndërtimi i dobët i kuadrit institucional - shtetëror, shoqëri të paqëndrueshme, kriza të vazhdueshme politike si rezultat i tensioneve etnike, dhe madje edhe kriza, tensioni dhe konflikti i vazhdueshme arabo islamik - Izraelit, pra gjithë këto mori problemesh me të cilat ballafaqohet ky rajon i trazuar i globit kanë të bëjnë me logjikën deformuese kognitive të *ndërhyrjes* kategorike në traditën botëkuptimore - intelektuale të trashëgimisë së tyre të përbashkët islame - muslimane nga koha e hershme e deri më sot. *“Prandaj kriza e tanishme në mendimin arab-islamik e ka origjinën në manipulimet politike, që ndaluan zhvillimin e proceseve të mendimit*

racional, duke e bërë historinë e mendimit musliman të dominohet nga ndikimet irracionale që rrjedhin nga traditat filozofike neoplatoniste dhe helenistike”⁴

Formimi (forma botëkuptimore) i mendjes muslimane në dimensionin politik (por dhe në atë logjik-filozofik) varet tërësisht nga vetëkthesa, vetëperceptimi (Davutoglu) që mund ta bëjnë rrethet e ngushta të institucioneve të specializuara në rrënjët e traditës së hershme të tyre, por me qasje dhe një etno-metodologji të mendimit të pastër intelektual e politik të tyre (Abdulvehab el Affendi: Islami dhe shekullarizmi në Lindjen e Mesme).

Sfidat e demokratizimit

Përgjegjësia e Perëndimit dhe e tërë globit për ndryshimet të cilat janë duke ndodhur në këtë rajon janë të mëdha dhe për këtë Evropa dhe amerikanët historikisht kanë një obligim të marrjes me këtë “tranzicion apo transformim” të cilin është duke e kaluar rajoni. Përkrahja ndaj një demokracie më të avancuar, institucioneve të lira, ndarjes së pushtetit, ndërtimit të gjyqësorit të fortë, luftës ndaj korrupsionit, të gjitha janë çështje të ngutshme të cilat duhet të jenë në rend dite dhe shqetësim i kancelarive perëndimore.

Sehiri ndaj zhvillimeve, blerja e kohës për regjimet e diktaturës e sidomos të Asadit dhe të tjera për rreth andej rajonit janë shumë të rrezikshme, të paktën nuk na lënë të qetë të mendojmë drejtë për botën e qytetëruar perëndimor e cila mundohet të jetë model dhe të shtretet e tillë në gjithë globin.

Sfidat për një konstituim të mirëfilltë të demokracisë në këtë rajon, por të një demokracie popullore të votës së lirë, është shumë e madhe dhe ndihma perëndimore duhet të jetë e pakursyeshme, ose në të kundërtën do të kemi “heshtjen” e qëllimshme ose atë formulën “kurva krihet derisa fshati digjet” gjë që nuk i shkon përshtati botës së lirë euro-amerikane!?

Literatura:

1. Regional Transition to democracy, 2011
(http://www.ccd21.org/military_handbook/volume_one/chapter3.pdf)
2. Huntington, Samuel P: Vala e Tretë: demokratizimi në fund të shekulli të njëzetë; Tiranë : AIIS, 2011
3. Davutoglu, AHMED: Vetëperceptimi i Qytetërimeve (2002; Logos-A; Shkup)

⁴ Muhamed Abdil el Xhabiri: sipas Abdulvehab el Affendi në kapitullin: “Racionaliteti i politikës dhe politika e racionalitetit - demokratizimi dhe ndikimi i traditave fetare islame”. Libri: “Islami dhe shekullarizmi në Lindjen e Mesme”, Logos-A Shkup, f.303, 2010.

4. Kegley JR, Charles ë: POLITIKAT BOTERORE - tendenca dhe transformim”; Shtëpia Botuese UFO Press, Tiranë, Mars 2008.
5. Ajvazi, SHEMSI: “GJEOPOLITIKA”; Dija, Prishtinë, 2009.
6. PARTOS, Gabriel “Bota që erdhi prej të ftohtit” 1994 CABEJ; Tiranë
7. Temimi, AZAMM & Esposito L, XHON “Islami dhe shekullarizmi në Lindjen e Mesme”; Logos-A Shkup 2010
8. Epistemologies of the South and Human Rights: Santos and the Quest for Global and Cognitive Justice, José-Manuel Barreto; Kate Hamburger Kolleg; 2014